

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurve N. A dhe S.A nga fshati G K. Gj, për shkak të veprës penale, Vjedhja e pyellit nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1007/2016, të datës 31.05.2016 të cilën e përfaqësonte Prokurori Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 23.05.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri N. A, nga i ati F e ëma Ke, e lindur Sh lindur ..në Gj me vendbanim në fshatin G e U, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i martuar- baba i dy fëmijëve, i gjendjes ekonomike të varfër, me numër telefoni shqiptar, shtetas i R. Kosovës , më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

I pandehuri S. A, nga i ati A, e ëma Fe, e lindur S lindur në Gjme vendbanim në fshatin G.e U, ka të kryer shkollën fillore, moler, i martuar- baba i dy fëmijëve, i gjendjes ekonomike të varfër, me numër telefoni..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës më parë i dënuar, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 23.05.2016, rreth orës 18:00 minuta, në fshatin Gumnishtë e Ultë, të pandehurit me qëllim vjedhje kishin shkuar në vendin e quajtur “..”, pronë private e të dëmtuarit A. Bu, dhe me sharrë motorike të markës “..” ngjyrë e kuqe, në mënyrë të pa lejueshme kanë prerë 115 copë, trungje të bungut, me vëllim të përgjithshëm 2.35 m2, me ç’rast tani të dëmtuarit Afrim i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej rreth 445 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s. Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46, 69, 73 dhe 75 të KP, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

I. Të akuzuarit **N. A**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari do ta paguaj në afat prej 60 ditë nga data kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

II. Të akuzuarit **S. Ai**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari do ta paguaj në afat prej 60 ditë nga data kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

III. Nëse të akuzuarit refuzojnë që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk janë në gjendje ta paguajnë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurve mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse të pandehurit nuk pajtohen me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

IV. Në bazë të nenit 69 të KPP, **KONFISKOHET** moto-shara e markës Ungjyrë e kuqe.

V. Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

VI. Obligohen të akuzuarit që veq e veq të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarve në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe

juridike në vet aktin e tillë shkresor.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 23.05.2017 Prokurori i Shtetit, Kujtesa Fazliu, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, duke i propozuar gjykatës të akuzuarit ti shpallë fajtor dhe ta dënnojë sipas ligjit dhe të konfiskoj moto-sharrën e sekuestruar.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaroi: i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të pandehurve dhe kërkoj që të denohen sipas ligjit dhe paraqesë kërkesë pasurore-juridike ndaj të pandehurve për dëmin e shkaktuar.

I pandehuri, në fjalën përfundimtare deklaroi: e ndiej vehten fajtor dhe pendohem për kryerjen e kësaj vepre penale, i kërkoj falje të dëmtuarit, më herët nuk kam shkelur ligjin dhe i prmentoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri, në fjalën përfundimtare deklaroi: e ndiej vehten fajtor dhe pendohem për kryerjen e kësaj vepre penale, i kërkoj falje të dëmtuarit, më herët nuk kam shkelur ligjin dhe i prmentoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit dhe të dëmtuarit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike nga neni 253 të KPP.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se të akuzuarit kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i shpalli fajtor të akuzuarit, për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën janë edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarve, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë; sjelljen korrekte në gjykatë, se janë penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, ndërsa rrethanë rënduese, rrezikshmëria shoqërore, dëmi i shkaktuar të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me gjobë, ndaj të akuzuarve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarve, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Në bazë të nenit 69 të KPP, është konfiskuar moto-shara e markës U... ngjyrë e kuqe.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s, kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP-s. Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 673/2016, Më 23.05.2017

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.